

DR. FANNY COHEN HERLEM  
**DIVORCI**  
SI T'U PËRGJIGJEMI PYETJEVE TË FËMIJËVE...

---

BOTIMET TOENA

DIVORCI,  
një fjalë e çuditshme  
që vjen nga latinishtja  
dhe që do të thotë:  
NDARJE.

Dr. FANNY COHEN HERLEM  
Pedopsikiatre

# DIVORCI

SI T'U PËRGJIGJEMI PYETJEVE TË FËMIJËVE...

Përktheu nga origjinali frëngjisht  
Mirela Skëndaj

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2021

Autori: Fanny Cohen Herlem (Fani Kohen Herlem)

Titulli në origjinal: Le Divorce - Comment répondre dux questions des enfants...

Botoi në frëngjisht: Éditions Pascal, juin 2005

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-348-00-5

© Editions Pascal; Fanny Cohen Herlem

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

[www.toena.al](http://www.toena.al)

*Historitë dhe shembujt  
e paraqitur në këtë libër  
janë marrë nga përvoja ime.  
Gjithë emrat e përmendur  
janë ndryshuar qëllimisht.*



# Parathënie

## TË JESH PRIND S'ËSHTË E LEHTË!

Të ndërthurësh jetën personale, jetën në çift dhe jetën si prind bëhet gjithnjë e më e vështirë, aq e vështirë, saqë edhe thyhemi!

Kështu, secili mund të vendosë ta vazhdojë i vetëm rrjedhën e jetës së vet, ose njëri nga të dy - për shumë arsye - mund të vendosë që jeta me tjetrin nuk i përshtatet më... Këto vendime, natyrisht, mund të shkaktojnë ndjenja faji, zemërimi, agresiviteti dhe ndonjëherë edhe ndjenja urrejtjeje.

Ne e dimë mirë që ndarja, divorci, janë ngjarje që në më të shumtën e rasteve janë të dhimbshme dhe vënë në pikëpyetje zgjedhjet, të përditshmen, planet për jetën. Edhe kur kalojnë butë, ndarja dhe divorci sjellin domosdoshmërinë e një riorganizimi të jetës së përditshme, çka shkakton shqetësime dhe vuajtje.

**Nëse desha ta shkruaja këtë libër, e bëra me qëllimin për të ndihmuar jo vetëm prindërit, por gjithashtu edhe ata që u mbeten atyre e përbashkët: fëmijët e tyre.**

Në parim, të rriturit i kanë burimet e nevojshme për t'u përballur me vështirësitë dhe me ndryshimet që ndeshin, por edhe nëse nuk i kanë këto burime, ata parimisht e dinë se mund të gjejnë njerëz që do t'i ndihmojnë.

Prindërit, që sot janë më të informuar dhe ndoshta edhe më të kujdesshëm sesa në të shkuarën, e dinë mirë që të gjitha këto ndryshime nuk do të kalojnë pa pasoja për fëmijët e tyre. Kështu, ata flasin me ta, u shpjegojnë, dhe së bashku me ta përpiqen të ndjekin hap pas hapi rrjedhën e procesit të ndarjes dhe ndryshimet.

Por, sa e vështirë është të kujdesemi për të tjerët, kur ka raste që e kemi të vështirë të kujdesemi edhe për veten!

Të përthithur nga gjithçka që kanë për të bërë dhe sistemuar, prindërit mund të mos vënë re sinjale që u dërgojnë fëmijët. E kam vënë re shpesh, se sa “të sjellshëm” mund të kenë qenë fëmijët, duke mos pyetur, duke mbajtur për vete pyetjet që kanë, kur e ndiejnë se ato mund të lëndojnë të rriturin në fjalë. Ata mund të jenë, gjithashtu, edhe “të padurueshëm”, por që shpreh aq pak nga ajo që fëmijët po kalojnë, sa që prindërit duke mos kuptuar çfarë po u ndodh mund të ndihen edhe vetë të humbur, të pafuqishëm dhe në ankth!

Fëmijët, në përgjithësi, nuk i pëlqejnë ndryshimet (përveçse, ndoshta, në rastin kur çifti, i përbërë nga prindërit e tyre, është bërë tepër konfliktual). Të mbërthyer në shtrengatë,



mes ankesave të dyanshme, krahëmarrjeve, zënkave (duke u marrë edhe si dëshmitarë) dhe dëshirës së tyre për t'i dashur të dy prindërit si dhe njëkohësisht “dhembshurisë” që kanë për njërin prej të dyve, të cilin e ndiejnë më të dobët, ata pyesin veten, shqetësohen dhe më pas ndihen të pasigurt sepse humbasin pikat orientuese. Ndonjëherë fëmijët i japin vetes rolin e mbrojtësit, të ngushëlluesit, madje edhe të drejtësisivënësit, aq sa mund të përshihen edhe në një konflikt besnikërie.

**Dhe... Fëmijët vuajnë në heshtje, ose zhurmshëm, duke shpresuar kështu të dëgjohen prej prindërve, të cilët nuk dëgjojnë, apo nuk shikojnë.**

Ky botim ka për qëllim t'u tregojë prindërve të gjitha pyetjet që “u vijnë” fëmijëve. Kështu, prindërit do të mund të krijojnë një ide për llojshmërinë e këtyre pyetjeve, për thellësinë që kanë dhe nganjëherë edhe për karakterin e tyre jetik.

Sa fëmijë ka, aq edhe pyetje ka!

Fëmijët nuk reagojnë të gjithë në të njëjtën mënyrë. Prindërit, po ashtu, nuk u përgjigjen në të njëjtën mënyrë pyetjeve të fëmijëve dhe as nuk e jetojnë ndarjen e tyre të gjithë njësoj. Fëmijët e jetojnë në mënyra të ndryshme ndarjen e prindërve të tyre dhe ndjenja e humbjes është ndoshta ajo që mbizotëron.

Shpesh fëmijët ruajnë shpresën e fshehtë që prindërit do të jetojnë përsëri bashkë. Kam takuar fëmijë që ende ishin të bindur për këtë, ndërkohë që të dy prindërit kishin krijuar

jetë të re dhe disa kishin pasur edhe fëmijë të tjerë. Për të thënë se sa e rëndësishme është të flasësh.

Fëmijët e shfaqin dhembjen e tyre në mënyra të ndryshme në sjelljen e tyre; ata janë më të ndjeshëm, më nervozë, të paqetë apo përkundrazi apatikë, flenë keq, s'e kanë mendjen në shkollë. Mund të mendojmë se duke folur për atë që ata i shqetëson, këto simptoma, duke i kuptuar, do të mund edhe të zgjidhen.

Duke publikuar këto pyetje të fëmijëve, mbledhur gjatë konsultave, si edhe ato të fëmijëve të tjerë, që i kam takuar në situata të tjera, duke mbledhur përgjigjet e dhëna (nga psikopediatri), shpresoj t'u ofroj lexuesve jo përgjigje “të gatshme”, por më tepër, një udhërrëfyes dhe një reflektim rreth temave të prekura nga fëmijët. Ky libër mundëson, gjithashtu, të dëgjohen pyetjet, që prindërit apo fëmijët i bëjnë vetes pa arritur t'i formulojnë. Këto përgjigje, që më së shumti janë të miat, janë gjithashtu edhe përgjigje prindërisht, apo fëmijësh të tjerë.

Sepse, sigurisht, më e rëndësishmja është që secili të gjejë brenda vetes përgjigjet që i përshtaten “më mirë”. Por, duhet të themi se nuk ka receta mrekullish!

## Përgjatë kapitujve të këtij libri, do të mësojmë që:

- Të përgatisësh fëmijën tënd për ndarjen është diçka e domosdoshme.
- Cilado qoftë mosha e fëmijës, gjithmonë ka diçka për t'i thënë për këtë ndryshim, që do t'i imponohet.
- Secili flet siç di dhe fëmija është krejtësisht në gjendje të kuptojë.
- Kritikat që kanë të bëjnë vetëm me prindërit duhet të mbeten mes tyre (fëmija ka nevojë që t'i dojë të dy prindërit dhe të ruajë të paprekur imazhin që ka skalitur për secilin).

Për këtë arsye, tërheq vëmendjen tuaj te kapitulli: “Gabimet” e prindërve dhe çështjet e “ndërlukuara” si edhe te “Mesazhet që fëmijët s’kanë pse t’i përcjellin”. Ky kapitull trajton çështjet delikate, që përfshijnë në mënyrë shumë intime, përvojën e secilit prind përballë ndarjes dhe jehonës së saj te fëmija. Asnjëherë s’do të mjaftojë të themi dhe të rithemi se sa e domosdoshme është që prindërit të mos ngarkojnë fëmijët me ankesat që kanë për njëri-tjetrin.

Për prindër të ndarë, apo të divorcuar, pa dyshim që ankesat mund të jenë të justifikuar, por shpesh shoh fëmijë që bëhen përcjellës mesazhesh dhe pritës të fjalëve që s’duhet t’i dëgjojnë. Dhe nëse “ne” mendojmë që, në këto raste, prindërit nuk i vënë re shqetësimet e rënda, që mund t’u shkaktojë fëmijëve, atëherë “ne” duhet t’u mësojmë fëmijëve

të ruhen jo nga prindërit e tyre, por nga pasojat e vuajtjeve që shkaktojnë këta prindër. Pasoja që i bëjnë - shpresojmë për një periudhë të shkurtër - më pak të vëmendshëm dhe më pak të kujdesshëm.

Të mos harrojmë që respekti i dyanshëm është thelbësor, në mënyrë që fëmija të mos vihet në një situatë të pamundur për ta përballuar, domethënë: ta dojë gjithsesi atë që është në shënjestër të kritikave, apo të bëhet palë me atë që kritikon, duke rrezikuar kështu të humbasë dashurinë e tjetrit. Duhet t'ua përsërisim shpesh fëmijëve që ata kanë vetëm një baba dhe vetëm një nënë dhe është thelbësore në këto kushte, të mos e harrojnë këtë!

Nëse për të rriturin në fjalë është e vështirë të kuptojë apo të arrijë të flasë me fëmijën e tij, përvoja ka treguar që një i rritur tjetër, i papërfshirë emocionalisht, mund ta ndihmojë një fëmijë t'i bëjë ballë asaj ç'ka po i ndodh. Prindërit, gjithashtu, nuk duhet të ndihen të nënvlerësuar kur i kërkojnë ndihmë një të treti, pasi është e vërtetë që s'mund të jemi objektivë para një situatë në të cilën jemi krejtësisht të përfshirë!


Le të jemi, megjithatë, optimistë; nëse prindërit bëjnë, në më të shumtën e rasteve, gjithçka munden për të shmangur që fëmijët e tyre të vuajnë, leximi i këtyre pyetjeve dhe i përgjigjeve të dhëna, do të mund t'i ndihmojë ata të "distancohen pak nga problemi dhe emocionet e veta".

Qëllimi i këtij libri është t'i japë guxim dhe mbështetje fjalës së secilit rreth kësaj teme të vështirë për t'u trajtuar.

Ky botim u adresohet prindërve (të rriturve, familjes, apo të afërme që mund të jenë, apo të ndihen të interesuar) dhe sigurisht u përkushtohet...

... fëmijëve.

Fanny Cohen Herlem



## “Historia” e Romenit dhe e Zhylisë

Zhorzhi dhe Maria kanë qenë bashkë në shkollë, ishin shumë miq, pastaj kuptuan që edhe pëlqeheshin dhe vendosën të martoheshin. Më pas lindën Romenin dhe Zhylin. *“Kur ishim të vegjël, gjithçka shkonte mirë në shtëpi, deri kur një ditë, babi u tregua shumë i keq me mamin. Kjo zgjati disa muaj kështu dhe pastaj, pa na e shpjeguar përse, babi u largua, për të mos jetuar më në shtëpi. Unë dhe Zhyli kishim shumë pyetje...”*

Ja një histori ndarjeje.

Ka shumë arsye që i detyrojnë dy prindër, të martuar apo jo, të vendosin të ndahen. Arsyeja kryesore është që ata nuk duhen më, por ka edhe arsye të tjera, që fëmijët mund të mos i dinë.

Ata do të ndiejnë, megjithatë, pasojat në jetën e tyre dhe do të jenë të prirur të pyesin prindërit e tyre për gjithë këto ndryshime.





## KAPITULLI I

### **Përse po ndahen prindërit e mi?**

Kur prindërit ndahen, kjo, shpesh, ndodh pas një periudhe të vështirë për ta. Debate, madje edhe sherre, në të cilat, shpesh fëmijët janë të pranishëm. Ndonjëherë fëmijët s'kanë vënë re asgjë dhe ndihen të befásuar, por edhe të shqetësuar sepse s'kuptojnë. Ata i duan të dy prindërit e tyre, por këta duket sikur s'duhën më. Atëherë, fëmijët pyesin veten, nëse prindërit do të vazhdojnë t'i duan po njësoj dhe mos janë ata shkak për këtë...

U takon prindërve të shpjegojnë gjërat duke u hequr fëmijëve çdo përgjegjësi.

#### **Natalia (7 vjeçe)**

*Pse po divorcohen mami me babin?*

E di çfarë? Historitë e dashurisë dhe të mosdashurisë janë gjëra sa të thjeshta, aq edhe të vështira! Përgjatë një jete ndryshojmë. Ndonjëherë, burri ose gruaja ndryshojnë siç

u përshtatet gjithsecilit, por që kjo mund të mos i pëlqejë tjetrit. Ka raste kur edhe puna u merr kaq shumë kohë, saqë s'arrijnë të shihen sa duhet dhe kështu mësohen të jetojnë sikur të ishin vetëm dhe të pamartuar.

Ndodh edhe që, babi ose mami takojnë një grua apo burrë tjetër dhe bien në dashuri me të. Atëherë, ata mendojnë se duan të jetojnë me atë tjetrën apo tjetrin, sesa me gruan apo me burrin që kanë aktualisht. Kjo ndodh, ndoshta, në një moment, kur ata kishin filluar tashmë të duheshin më pak. Pastaj ka edhe arsye të tjera, por që u takojnë atyre, si të rritur që janë, edhe pse pasojat e këtyre arsyeve bien mbi ty, nuk të takojnë t'i dish.

Janë “gjëra” që janë shumë personale për ta.

Çfarë gjërash?

E vështirë të përgjigjesh!

Por edhe ti ke sekrete, marrëdhënie me shoqet e tua, për të cilat mendon se prindërit e tu s'kanë pse t'i dinë, gjëra që të përkasin vetëm ty...

Edhe për ta është njëlloj.

*Atëherë s'më duan më?*

Dashuria e prindërve mes tyre është një dashuri të rriturish. Është shumë ndryshe nga dashuria e një prindi për fëmijën e vet dhe megjithëkëtë situatë të re, ata patjetër që do të vazhdojnë të të duan.

*Po ata më bërtasin edhe më shumë dhe shumë shpesh nxeben me mua!*

E di? Një ndarje, edhe kur e kemi vendosur vetë, s'është asnjëherë kaq e lehtë ta kalosh. Kjo i bën prindërit e tu të jenë në humor të keq dhe ngaqë janë të shqetësuar për gjithçka bëhen dhe të inatosur me njëri-tjetrin, mund të bëhen më pak të durueshëm, apo më pak të kujdesshëm sesa zakonisht... kështu që s'janë gjithmonë shumë të drejtë, por kjo s'do të thotë që s'të duan më!

### **Zhyli (7 vjeç)**

*Ndoshta të gjitha këto ndodhën për fajin tim! Ndonjëherë them me vete se po të kisha qenë më e sjellshme apo më e dëgjuar, ata s'do të ziheshin me njëri-tjetrin.*

Mendoj me të vërtetë, që s'duhet ta mendosh këtë! Është diçka që ka ndodhur mes tyre, jo me ty! Edhe sikur, ti të kesh qenë shkaku i zënkave të tyre, ata nuk u ndanë për shkakun tënd. Arsyeja e sherreve të tyre, ndoshta ishte ti, por ajo që i shtynte të ziheshin ishte mënyra e ndryshme e të menduarit të gjërave në lidhje me ty, por s'ishte për shkakun tënd si fëmijë.

*Atëherë i kujt është fajti?*

Nuk mendoj se mund të flasim për "faj" në këtë histori! Ose le të themi që është fajti i atyre të dyve!

*Po përse nuk përpigën të vazhdojnë të jenë bashkë? Kur zihem me shoqet e mia, prindërit më thonë të bisedoj me to dhe pastaj do të rregullohet...*

Sepse historitë e fëmijëve - midis fëmijëve - edhe pse janë shumë të rëndësishme, janë shumë ndryshe nga historitë e të rriturve! Arsyet e mosmarrëveshjes mes prindërve të tu janë shumë të thella, përderisa shkuan deri në divorc, sepse të jetosh së bashku apo të vendosësh të ndahesh ndryshon një jetë, por ndryshon gjithashtu, në njëfarë mënyre, edhe jetën e fëmijëve.

*Ata mund të kishin menduar edhe për mua dhe për vëllanë tim, Romen!*

Mendon se kjo, ndoshta, do t'u kishte ndryshuar mendjen? Prindërit e tu, patjetër që mendojnë për ju të dy. Ata e dinë, gjithashtu, që nuk është diçka e mirë për fëmijët, të kenë apo të shohin prindër që s'duhen më dhe që grinden. Ata bëjnë, pra, atë ç'ka mendojnë se është më e mira për ju dhe për ta.

### **Sebastiani (10 vjeç)**

*Edhe unë po divorcohem?*

Shpesh dëgjoj fëmijë të më thonë: “*mami dhe unë (ose babi dhe unë) u divorcuam...*”. Dhe u them gjithmonë, që divorci është i të rriturve, jo i tyre... Prindërit e tu, kudo qofshin,

edhe të ndarë, edhe nëse s'duhen më, edhe nëse janë shumë të inatosur me njëri-tjetrin, ata mbeten prindërit e tu. Divorci është diçka që ka të bëjë me ata si të rritur, që në një moment të jetës së tyre, kanë vendosur të mos e vazhdojnë më rrugën së bashku, edhe pse ishin martuar për ta kaluar gjithë jetën bashkë. Por fëmijët që patën së bashku, do të mbeten gjithë jetën fëmijët e tyre. Kjo s'ka lidhje me mobiliet ose shtëpinë, as edhe me macen, ose qenin që do të ndajnë mes tyre! Ti do të kesh një baba dhe një mama, përgjithmonë.

*Po sikur të mos ishin martuar?*

Për ty është e njëjta gjë. Pa dyshim do të jetë ndryshe për ta, por jo për ty.

Shkolla



## KAPITULLI II

### Si do të shkojnë gjërat?

Me divorcin e prindërve shumë gjëra ndryshojnë. Edhe nëse gjithçka shkon më së miri dhe fëmija i takon rregullisht të dy prindërit, ai prapë mund ta ketë pak të vështirë të përshtatet me këtë jetë të re, pa kuptuar mirë përse.

Më parë, ai kishte një jetë të organizuar në një mënyrë të caktuar. E gjitha kjo ishte shumë qetësuese, por më pas pikat e orientimit ndryshojnë; mund të ndryshojë vendi ku jeton, oraret, zakonet, gjithë gjërat e vogla, që për fëmijën ishin të njohura, të zakonshme. I duhet të përpiqet të kuptojë përse i duhet të mësojë të jetojë ndryshe, gjë që s'është gjithmonë shumë e lehtë për fëmijët, por as edhe për të dy prindërit e tij. Secili duhet të mësojë të jetojë ndryshe, edhe prindërit duhet të përpiqen t'u përgjigjen shqetësimeve të fëmijëve të tyre, të krijuara nga gjithë këto ndryshime, por edhe fëmijët duhet të gjejnë vendin e tyre në këtë jetë të re.

## Gabriela (9 vjeç)

*Te kush do të jetoj?*

Është gjykatësi, ai që do të thotë se te cili do të jetosh zakonisht. Ai do të vendosë gjithashtu cili do të ketë Kujdestarinë prindërore. Në përgjithësi, prindërit kanë një Kujdestari prindërore të përbashkët. Gjykatësi do të përcaktojë edhe kohën kur ti do të shkosh te prindi tjetër, në përgjithësi çdo dy fundjava dhe gjatë gjysmës së pushimeve. Por nëse prindërit e tu merren vesh mes tyre, ti mund të shkosh ta takosh tjetrin më shpesh dhe për më gjatë...

Çfarë është Kujdestaria prindërore e përbashkët?

Kjo do të thotë që ata janë të dy përgjegjës për ty. Ata nuk mund të marrin vendime të rëndësishme për jetën tënde pa lajmëruar njëri-tjetrin. Për shembull, nëse ti duhet të ndryshosh shkollën, apo nëse njëri prej të dyve dëshiron që ti të kesh një formim fetar, ose të pajisesh me kartë identiteti... Kjo do të thotë, gjithashtu, që të dy prindërit e tu duhet ta dinë ecurinë tënde në shkollë, që mund të vijnë të takojnë mësuesit, që mund të firmosin fletoren tënde të notave...

*Po nëse kam marrë ndonjë notë jo të mirë, do të thotë që do të më qortojnë të dyja palët?*

Ndoshta, por, po të kesh nota të mira, do të përgëzohesh nga të dyja palët, gjithashtu!



*Po nëse dua të shkoj te gjyshja të mërkurën, ose të ftoj Letisiën, duhet t'u marr leje të dyve?*

Jo, sepse edhe pse për ty është e rëndësishme, kjo nuk e ndryshon organizimin e jetës tënde!

### **Zhonatan (10 vjeç)**

*Kush do ta mbajë shtëpinë ku jetojmë tani?*

Ka mundësi, që ti të qëndrosh me prindin në të njëjtin apartament ose në të njëjtën shtëpi, por, ti e di që për arsye paraje apo arsye praktike, kjo gjë nuk është gjithmonë e mundur. Qiraja mund të jetë shumë e shtrenjtë për atë që mban shtëpinë, shpesh mamit ose babit i duhet të gjejë një punë të re, ose të ndërrojë punë dhe të largohet nga vendi ku banonit.

Mamaja jote - nëse ti do të jetosh me të - mund të shkojë të jetojë afër prindërve të saj, apo pranë miqve që mund ta ndihmojnë për të të mbajtur. Ndodh pastaj, që as njëri e as tjetri s'ka dëshirë të qëndrojë aty ku keni jetuar të gjithë së bashku. Kanë dëshirë për një vend të ri, që ta rregullojnë, për të filluar një jetë të re.

Por sido që të vijë puna, ti s'do të mbetesh kurrë në rrugë! Edhe kaq, ndryshimet janë shumë!

*Do të ketë ndryshime të tjera?*

Përveç ndryshimit të vendit, ku do të banosh, ndoshta do të ndryshojë edhe mënyra jote e jetesës. Nëse mamaja jote nuk punonte, ndoshta tani do të jetë e detyruar të punojë, kështu, do të ketë më pak kohë për ty.

Prindërit e tu, sigurisht, do të kenë më pak para, sepse gjithçka që e kishin të përbashkët, tani do t'u duhet ta blejnë secili më vete, p.sh.: një makinë, një larëse rrobash, një dollap, apo krevate...

Pastaj, kur të jesh më i rritur, do të të kërkojnë, sigurisht t'i ndihmosh pak, t'i bësh vetë gjërat e tua, të të shkojë vetë mendja për të rregulluar krevatin, apo të vendosësh në vend enët e lara, të fusësh rrobat në makinën larëse, të shkosh të blesh bukë etj. Ndoshta do të të duhet të shkosh të marrësh motrën e vogël në shkollë, ngaqë mami ose babi s'munden, ndoshta do të të duhet t'i japësh edhe për të ngrënë pasditen... Por, a e di? Të gjitha këto janë thjesht çështje kohe. Në fund, gjërat e reja shpejt pranohen dhe po shumë shpejt mësohemi me një mënyrë të re jete!

## **Hektori (11 vjeç)**

*Kush e cakton numrin e ditëve që do të rrijmë me mamin apo me babin?*

Në parim, është më mirë kur të dy prindërit merren vesh për këtë pikë, por nëse ata s'bien dakord, do të vendosë

gjykatësi. Në përgjithësi, fëmija jeton te njëri nga prindërit dhe shkon të takojë tjetrin një fundjavë po, një jo, por prindërit e tu mund të vendosin së bashku me ty, për mënyra të ndryshme organizimi. Ti mund të rrish gjysmën e javës te mami dhe gjysmën tjetër te babi, apo çdo dy javë, ose, ose, nëse jeton me mamin - nëse është e mundur - do të shkosh te babi të martave në darkë, për të qëndruar me të të mërkurën.

*Përse nuk është njësoj për të gjithë?*

Sepse kjo varet nga shumë gjëra. Sidomos nga oraret e prindërve. Dhe pastaj, nganjëherë edhe nga prania e gjyshërve pranë prindërve, të cilët mund të vijnë të të marrin nga shkolla, apo të të ndihmojnë për të bërë detyrat...

*Po sikur të jetoj me babin, a mundem të takoj mamin?*

Sigurisht, ti ke të drejtë t'i takosh të dy prindërit e tu! Patjetër, kjo duhet të organizohet. Ata do të vendosin, ndoshta, që të mërkurën ti do të shkosh te mami ose secili sipas radhës do të vijë të të marrë nga shkolla, ose njëri prej tyre do të të çojë në kursin e gjimnastikës, sepse kjo i jep kënaqësi ose ngaqë orari i punës ia mundëson këtë. Pastaj, çdo dy fundjava, do të shkosh te mami, nëse jeton te babi, si edhe gjatë pushimeve. Mund edhe t'i kërkosh prindit me të cilin jeton, që në një kalendar të të tregojë ditët kur do të shkosh te prindi tjetër. Ti mund t'i ngjyrosësh dhe ta

vendosësh këtë kalendar në dhomën tënde ose në kuzhinë, kështu, do ta dish me saktësi si është organizuar për ty java që vjen, ose muaji.

### **Karolina (10 vjeç)**

*Kush vendos për paratë që mami, apo babi duhet të japin?*

Prindërit merren vesh me njëri-tjetrin për të caktuar sa para do t'i jepen prindit tek i cili do të jetosh, por ka raste që ata e kanë të vështirë të merren vesh. Atëherë vendos gjykatësi. Për paratë, ai vendos në varësi të asaj çka fiton secili nga prindërit dhe të asaj çka është e domosdoshme për edukimin tënd, ai vlerëson se cili është interesi yt.

*Po unë kam një shoqe, që thotë se mamaja e saj ankohet ngaqë babi nuk jep para sa duhet dhe kështu ajo s'mund të ketë gjithë ç'ka pasur më parë!*

E kuptoj, që kjo të shqetëson dhe pyet veten nëse do t'ju ndodhë edhe juve e njëjta situatë. Ndodh që prindërit zihen për problem parash dhe i bëjnë edhe fëmijët pjesë në këto probleme; mendoj që prindërit duhet të përpiqen ta zgjidhin mes tyre dhe t'i lënë fëmijët jashtë nga këto lloj problemesh. Është e vërtetë, gjithashtu, që kur nuk jetohet më bashkë, ka më pak para. Ndoshta duhet pritur pak, derisa të blesh atletet që të pëlqejnë, ose atë bluzën aq të bukur, parashikuar të blihej për pushime. Mundet, ndoshta të provosh t'i

pyesësh ata se cili mund të jetë buxheti yt për veshje apo argëtime. Pastaj mund të fitosh edhe ca para xhepi, duke kryer shërbime të vogla, nëse të jepet rasti.

### **Natasha (9 vjeç)**

*Vëllai im jeton me mamën, unë me babin. A jemi të divorcuar ne të dy?*

Jo, sigurisht që jo, janë prindërit ata që divorcohen, jo fëmijët!

*Kur mund ta takoj vëllanë tim?*

Mund të organizohesh me të, ose ta zgjidhin prindërit e tu, që ju të shiheni kur të keni dëshirë. Sigurisht që ti do ta takosh gjatë fundjavave, që do të shkosh te mami dhe ai do të vijë fundjavave, kur ti je me babin. Pastaj, janë pushimet. Për mbrëmjet është një organizim, që varet nga detyrat që keni për të bërë, nga largësia midis shtëpive tuaja... dhe nga prindërit tuaj.

### **Ana Maria (9 vjeç)**

*Babi më tha që jam në kujdestari të alternuar.*

Do të thotë që prindërit e tu kanë arritur të bien dakord që ti të kalosh të njëjtën kohë sa te njëri, aq edhe te tjetri,

zakonisht një javë te mami, një javë te babi. Dhe kur je te njëri prind duhet të mbash kontakte edhe me prindin tjetër.

*Po sikur prindërit e mi të mos jetojnë në të njëjtin qytet apo në të njëjtin shtet?*

Në përgjithësi, nëse nuk mund të shkosh për të kaluar fundjavën, ngaqë është shumë larg, gjykatësi vendos, që ti të kesh pushime më të gjata me prindin që jeton larg teje.

*Po gjyshin me gjysben do të vazhdoj t'i takoj?*

Nëse ti do t'i takosh apo nëse ata duan të të takojnë, sigurisht që do t'i takosh. Askush s'mund të të ndalojë! Pastaj gjyshërit kanë të drejtë t'i takojnë nipërit dhe kur nuk merren vesh me prindërit, ata duhet t'i kërkojnë gjykatësit një ditë vizite.

*Po pjesën tjetër të familjes sime?*

Sigurisht që do të mund të vazhdosh t'i takosh, por zakonisht me babin do të takosh të afërmit nga ana e babit dhe me mamin të afërmit nga mami. Kjo varet nga marrëdhënia që kanë ruajtur prindërit me të afërmit e tyre.